



Npi – 01/67 datë: 02.04.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 02.04.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T **P R O C E S V E R B A L**

I Mbledhjes së -II- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 02.04.2026 (e enjte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Rrahman Jakupi. Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Artan Lubovci, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari, z.Adnan Ademi; DBF, z.Besnik Ahmeti; DPP, z.Valon Januzi, DZHE, z.Grejtalb Emini; DSHMS, znj.Mimoza Salihu Qeriqi, Zyrtare, znj.Vlora Hyseni, Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi; OSBE, z.Mefail Mustafa; Praktikantët, z.Albion Shabani, znj.Hava Llugaxhija, znj.Admire Selmani, znj.Teuta Mustafa, znj.Valmira Behluli. Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi e njoftoi Kuvendin me rendin e ditës të propozuar si vijon:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 05.03.2026,
2. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026,
3. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF),
4. Emërtimi i anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës,
5. Pasqyrat Financiare për vitin 2025,
6. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/26,
7. Informatë për Planin e Punës të Drejtorisë së Prokurimit,
8. Pyetje – përgjigje.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Para se të hapi mbledhjen e dytë të rregullt të Kuvendit të Komunës, meqenëse sot kemi 27 vjetorin e rënjes heroike të dëshmorit z.Shefket Muhadini, propozoj 1 minutë heshtje për të, kështu që si anëtarë të Kuvendit ju ftojë ta nderojmë dëshmorin. Konstatoj korumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Kuvendi i Komunës mbajti një minut heshtje, për nder të dëshmorit Shefket Muhadini.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Atëherë unë si pikë shtesë propozoj që të futet shfuqizimi i vendimit Npi-01/17 të viti 2011, si dhe ndryshimi i nenit 6.9 të Rregullores së punës së Kuvendit në mënyrë që të i mundësoj Kuvendit që drejtëpërdrejt të i shqyrtojë kërkesat e qytetarëve. Arsyeja e shtimit të këtyre pikave është se qytetari është palë kërkuese dhe vendos se kujt të ju drejtohet me kërkesat e tij.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Sa i përket pikës Pasqyrat Financiare, pa dashtë me bërë politike këtë punë mirëpo nuk është një dokument që duhet vetëm me e lexuar por me u studiuar bukur thellë. Ne si grup parlamentar i LDK-së jemi që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër, ngase Pasqyrat Financiare kanë ardhë shumë me vonësë.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Unë nuk i përkrash propozimet e Demokratit, por vetëm pikat e rendit të ditës të propozuara nga Kryesuesi.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Duke marrë parasysh që ka ardhur nga ana juaj si Kryesues i këtij Kuvendi, mendoj që jeni dakorduar që duhet të jenë të tilla. Këto takime kanë për të u stërgjatur duhet të jetë një komision i veçantë për shkak të numrit të madh të kërkesave, pajtohem me rekomandimet e LDK-së, mendoj që raporti financiar duhet me ardhë me kohë dhe jo të vije në 24h e fundit sepse këto materiale dojn shfletim. Si grup parlamentar jemi pro këtyre pikave ashtu siç janë ardhur nga ana juaj si Kryesues.

z.Demokrat Mujota: Pajtohem me kërkesën e LDK-së. Nuk e kuptoj se si ka mundësi që një parti politike me mbi 50% me pas frikë nga kërkesat e qytetarëve që vijnë në Kuvend. Nuk po e kuptoj se si në këtë mënyrë arbitare një parti me pretendu me e mbyllë një derë për qytetarët, që është mbyllë në 2011. Për mua atëherë ka qenë gabim prandaj është kërkesa që sot me u hap kjo derë. Ju bëj kërkesë që të bëhemi bashkë ta votojmë këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Po më vjen keq me thënë por para se me e formuar kjo pikë, po e propozoj një pikë brenda kësaj pike e që është formimi i një Komisioni të anëtarëve për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve të Komunës së Shtimes, do të ishte shumë më legjitime.

z.Shefqet Krasniqi: Ne si grup i LDK-së kërkojmë një pauzë 3-4 minuta në mënyrë që shefat e grupeve parlamentare të konsultohen, dhe të gjejnë një gjuhë të përbashkët. Sepse nuk është që nuk më pëlqej edhe propozimi i Besnikut. Po ashtu edhe propozimi i Demokratit dhe kërkesa e tij është shumë me vend.

z.Muhamet Ademaj: Askush nuk është kundër kërkesave të qytetarëve, mirëpo rregullorja dhe Statuti i Komunës ashtu e jep. Nese dëshironi e themelojmë një Komision për shqyrtimin e këtyre kërkesave.

z.Demokrat Mujota: Në administratën e sporteli bëhet ndarja e kërkesave. Përderisa ekziston administrata pse ne me humbë ekstra kohë për themelimin e një Komisioni për shqyrtimin e kërkesave, qytetari e përcakton kërkesën e vet se ku dëshiron me e dërguar.

z.Haqif Arifi: Ne kemi diskutuar rreth kësaj pike. Në institucione nuk ka zyrë pritëse por arkiv. Në ligjin për arkiva shkruan se ku duhet të drejtohet dokumenti dhe ku e ka destinimin. Te arkiva adresohen këto kërkesa, dhe jo kërkesat me shku nëpër gjepa dhe mos me ditë qytetari se ku i ka mbetë kërkesat apo ankesa e tij.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Në rregull atëherë 5 minuta pauzë për shefat e grupeve parlamentare që të konsultohen.

z.Demokrat Mujota: Pas dakordimit 5 minuta të pauzës u konsultuam të shfuqizohet vendimi dhe të formohet një Komision për shqyrtimin e kërkesave prej 3 anëtarëve, Kryesuesit dhe bashkëpuntores profesionale të Kuvendit. Si dhe të votohet pika e dytë e propozuar.

z.Besnik Seferi: Meqenëse z.Adnan Ademi ka përvojë kisha kërkuar një mendim për këtë pikë, edhe pse prezent do të duhej të ishte edhe zyrtari ligjor.

z.Shefqet Krasniqi: Do të dëshiroja që të hyja me një marrëveshje të kompletuar megjithatë, u diskutuan dy çështje, ku LDK-ja ka kërkuar që të gjitha kërkesat nga qytetarët që i drejtohen Kuvendit të i përgjigjet Kuvendi atyre kërkesave. Por nëse një kërkesë i drejtohet një drejtorie të caktuar, nëse nuk ka zgjidhje të i drejtohet Kuvendit. Dhe ne prapë si grup i LDK-së jemi edhe për propozimin e Besnikut, që të formohet një Komision për shqyrtimin e kërkesave, të shohim se cilat kërkesa duhet të i shqyrtojë Kuvendi. Jemi në mes dy propozimeve, megjithatë të marrim një vendim që qytetarëve të ja u hapim edhe një derë për shqyrtimin e kërkesave.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Përshëndetje. Sa për sqarim pika e parë përveq ligjeve e ka edhe Statutin e Komunës. Duhet me u bërë një Komision që të ndryshohet Statuti i Komunës së Shtimes, ku duhet të jenë të gjitha subjektet bashkarisht që të ndryshohet. Me votë unanime është votuar vendimi që çdo kërkesë të shkojnë te ekzekutivi. Brenda 30 ditëve duhet të bëhet shqyrtimi i kërkesave, dhe ju kthehet një përgjigje qytetarëve se ashtu e thotë ligji. Keni me shkelë Statutin e Komunës. Nuk mundeni me bërë Komision për të gjitha kërkesat që vijnë. Nëse dëshironi me e futë si pikë shtesë duhet me ndryshuar Statutin e që shans nuk ka sepse duhet me i pas 2/3 të votave për me ndryshuar, duhet me e ndryshuar Rregulloren, me shfuçizu këtë vendim dhe për çdo kërkesë duheni me bë nga një Komision.

z.Haqif Arifi: Statuti me sa e di është miratuar në 2008, ndërsa një vendim paraprak ka qenë deri në 2011, saktësisht çka po thotë në Statut dhe se përmendi askush me e ndryshuar Statutin. Ky Komision është për shqyrtim të ankesave edhe këtë nuk e ndalon askush.

z.Faruk Beqa: Përshëndetje. Unë u konsultova për të drejtat dhe përgjegjësit e Kuvendit dhe Ekzekutivit, unë konsideroj me marrë përsipër edhe praktikat e Komunave tjera se si po veprojnë në tërësi, sepse ka mundësi që të shkelim Statutin edhe Rregulloren, që të mos humbim kohë të panevojshme. Mirë është me u sqaruar të gjitha.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Askush nuk po thotë me e ndryshuar Statutin, e kemi si propozim shfuqizimin e vendimit si dhe nenin 6.9 të rregullores së punës së Kuvendit si dhe propozimin e LVV-së që të bëhet një Komision. Tani sipas rregullores duhet t'a hedhim në votim rendin e ditës ashtu siç ka ardhur. Pastaj vazhdojmë me propozimet.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes me 7 vota "Për" 12 vota "Kundër" dhe 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi rendin e ditës.**

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Tani duhet ta qesim në votim rendin e ditës me propozimet e bëra.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes me 12 vota "Për" me 7 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi rendin e ditës, me largimin e pikës 5. "Pasqyrat Financiare për vitin 2025", si dhe me pikat shtesë si në vijim:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 05.03.2026,
2. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026,
3. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF),
4. Emërtimi i anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës,
5. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/26,
6. Informatë për Planin e Punës të Drejtorisë së Prokurimit,
7. Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit Npi-01/17 datë 31.01.2011, (Pikë shtesë)
8. Propozim-Vendim për ndryshimin e nenit 6.9 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 datë 27.04.2023, (Pikë shtesë)
9. Pyetje – përgjigje.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 05.03.2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Sa i përket procesverbalit realisht çdo procesverbal po vjen nga pak me disa mangësi, po nëse të gjithë kishim ra dakord me kalu këtë pikë, në rregull e votojmë por kërkesat tona për shtimin ose largimin e fjalive me i bë direkt në zyrën adekuate ose përmes email-it zyrtar që të mos humbim kohë.

z. Shëfqet Krasniqi: Singërisht herën e parë dhe të dytën kemi falë, në atë kuptimin që nuk jemi për të gjykuar gabimet teknike dhe mund të bëhen ato, po jo të përsëriten. Edhe njëherë po duhet me ju lutë. Çuditërsisht dhe nuk kam fare dyshime që po bëhen me qëllim absolutisht, por në konsult edhe me grupin e LDK-së, po mungon kuptimi nëpër proceverbale. Andaj si grup i LDK-së kemi vërejtje dhe kërkojmë që të mos bëhen këto gabime herave të tjera.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime të tjera, po e hedh në votim këtë pikë.
***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi Ekstrakt - Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më: 05.03.2026, me vërejtje dhe rekomandime.**

Pika 2

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë fjalën ja dha z.Muhamet Ademaj.
z.Muhamet Ademaj: Unë kisha propozuar me e mbajtë mbledhjen e Dhjetorit me datën 23 apo 24 dhjetor. Pasi që janë festat pastaj dhe ndodh dikush dëshiron me i lidhë ditët për pushime.
z.Shefqet Krasniqi: Jemi dakord me atë që e thotë profesori.
znj.Erza Salija: E respektoj mendimin dhe qëndrimin tënd z.Ademaj, por më vjen keq që dëshira jote individuale nuk mundet me e ndërru në një vendim kolektiv.
z.Bajram Hajrizi: Jemi dakorduar me atë propozim-vendim si dhe me orarin e mbledhjeve.
znj.Adelina Shabani: Ora duhet të jetë e njejta ndërsa për datën e dhjetorit si të doni.
z.Faruk Beqa: Ideja për me e ndryshuar është në rregull.
z.Besnik Seferi: Po pajtohem me z.Muhamet Ademaj dhe e marrë parasyshtë se mundemi me e lidhë me pushim, dhe në gjë çka kisha propozu data 30 Tetor të ndryshohet, mbledhja të mbahet me datë 29 Tetor vetëm që dita e Xhuma të jetë ditë e lirë, sepse të gjithë praktikojmë namaz. Besoj që të jemi të gjithë të pajtimit si grupe.
znj. Erza Salija: Shkojmë në konsensus të votimit të partive.
z.Shefqet Krasniqi: Megjithatë pasi që kemi mundësi me i bë këto ndryshime dhe pa një të keqe, e shpjegoi edhe Kryetarja e Komisionit që i falenderoj për punën që e kanë bërë, por disa data që është mirë të ndryshohen sikur e përmendi kolegu çështja e namazit, po ashtu mbledhja e datës 27 Maj të mbahet me datën 28 Maj.
***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi vendimin për orarin e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes. me ndryshimet e propozuara.**

Pika 3

Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF):

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Atëherë çelsi duhet të jetë 2+1 ashtu siç e ka propozuar LVV-ja, pastaj 2 PDK, 2 LDK duke e respektu kuotën gjinore.
z.Shefqet Krasniqi: Besoj që kjo temë është shtjerrë dhe propozoj të shkojmë në votim.
z.Faruk Beqa: Nga LVV-ja propozoj z.Besnik Seferi, znj.Yllkë Fejzullahu dhe z.Muhamet Ademaj.
z.Demokrat Mujota: Pasi që Kryesuesi nga PDK-ja shkon atëherë e propozoj edhe znj.Albana Hoxha Podvorica.
z.Haqif Arifi: Nga LDK-ja propozoj znj.Frosina Berisha-Ahmeti dhe z.Shefqet Krasniqi.
***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërjen si vijon:**
1. z.Rrahman Jakupi- PDK,
2. znj.Albana Podvorica- Hoxha- PDK,
3. znj.Frosina Berisha-Ahmeti- LDK,
4. z.Shefqet Krasniqi- LDK,
5. z.Besnik Seferi- LVV,
6. znj.Yllkë Fejzullahu- LVV,
7. z.Muhamet Ademaj- i pavarur.

Pika 4

Emërtimi i anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha z.Demokrat Mujotës.

z.Demokrat Mujota: Edhe kjo temë është shtjerruar dhe propozoj të shkojmë me propozimet.
z.Besnik Seferi: Këtu kemi me qenë me 5 anëtarë. Për KASHUP propozojmë znj.Uskana Deliu, për KSHMS znj.Adelina Shabani dhe z.Zenel Shabani, si dhe z.Faruk Beqa për KAKRS.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Kisha propozuar që anëtarët e partive të i shënojnë emrat e anëtarëve të tyre në një letër dhe pastaj të mi sjellin. Atëherë po i lexoj emrat, për KAKRS është propozuar znj.Adelina Shabani, LVV; z.Zenel Shabani, LVV; z.Demokrat Mujota, PDK; znj.Erza Salija, LDK; z.Bardhyl Haxhiu, ekspert i jashtëm. Për KSHMS z.Faruk Beqa, LVV; znj.Arbresha Sylja, PDK; z.Haqif Arifi, LDK; znj.Albulena Deliu, eksperte e jashtme; znj.Adelina Beqaj, eksperte e jashtme. Për KASHPU, z.Faik Ramadani, PDK; z.Bajram Hajrizi, PDK; z.Atdhe Isufi, LDK; znj.Uskana Deliu, LVV; znj.Egzona Selmani eksperte e jashtme.

z.Shefqet Krasniqi: E kemi një propozim për të gjithë emrat që vin nga jashtë të votohen veqmas me një pako tjetër.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nuk është problem.

z.Besnik Seferi: Kërkova mirëkuptim meqë e kemi mangu një anëtar të Kuvendit, të lihet një vend për anëtarin tjetër të rradhës.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Po i hedhë në votim emrat e propozuar

***Kuvendi i Komunës së Shtime, unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në përbërjen si vijon:**

1. znj.Adelina Shabani- LVV,
2. z.Zenel Shabani- LVV,
3. z.Demokrat Mujota- PDK,
4. znj. Erza Salija- LDK,
5. z. Bardhyl Haxhiu- ekspert i jashtëm.

***Kuvendi i Komunës së Shtime, unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në përbërjen si vijon:**

1. z.Faruk Beqa- LVV,
2. znj.Arbresha Sylja,- PDK,
3. z.Haqif Arifi- LDK,
4. znj.Albulena Deliu- eksperte e jashtme,
5. znj.Adelina Beqaj- eksperte e jashtme.

***Kuvendi i Komunës së Shtime, unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm në përbërjen si vijon:**

1. z.Faik Ramadani- PDK,
2. z.Bajram Hajrizi- PDK,
3. z.Atdhe Isufi- LDK,
4. znj.Uskana Deliu- LVV,
5. znj.Egzona Selmani- eksperte e jashtme.

Pika 5

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/26

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha z.Besnik Seferit.

z.Besnik Seferi: Nga subjekti i LVV-je, e propozojmë z.Faruk Beqa.

Znj.Frosina Berisha: Nga subjekti i LDK-së e propozojmë z.Haqif Arifi.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht e miratoi, Vendimin për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e Bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026, në përbërjen si vijon:**

1. z.Haqif Arifi.....(Përfaqësues nga pozita),
2. z.Faruk Beqa.....(Përfaqësues nga opozita).

Informatë për Planin e Punës së Drejtorisë së Prokurimit:

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin dhe fjalën ja dha z.Valon Januzi.

z.Valon Januzi, DPP: Përshendetje. Po besoj e keni marrë planin e Prokurimit me kohë dhe keni pa të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen në vitin 2026. Në vazhdim lexoi të dhënat mbi informatën për planin e punës së Drejtorisë së Prokurimit. Nëse dikush ka pyetje jemi të hapur, urdhëroni.

znj. Fatlinda Rrafshi: Përshendetje. Kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pse në planin e Prokurimit është planifikuar shuma në vlerë prej 350.000 mijë euro për mirëmbajtjen e infrastrukturës në komunën e Shtimes, kur dihet se projektet janë investime të reja. Duke pas parasysh që mirëmbajtja nënkupton zakonisht dëmtime dhe riparime të rrugëve. Lind pyetja nëse kjo shumë është e drejtë për këtë punë përndryshe nëse është menduar si projekt i ri, a duhej të ishte tek lista e projekteve kapitale? Realisht mendova mos keni bërë ndonjë marrëveshje me nivelin qendror për rregullimin e Ankesit në rrugën Carralevës, e cila duhet të jetë prioritet pasi që gjendja është emergjente dhe kalimtarët që e frekuentojnë atë rrugë po e kërkojnë rregullimin sa më të shpejtë.

z.Muhamet Ademaj: Po shihet se është bërë një punë e mirë, shumica e projekteve fillojnë në mars të vitit 2026 me u realizuar. Mirëpo sa është realizuar plani?

z.Bajram Hajrizi: Para se me dal te planifikimi përfundimtar i Prokurimit dua t'ia bëj një pyetje drejtorit, z.Valon Januzi. A na tregon puna juaj si një drejtor që nuk po përputhet me veprimet edhe dokumentacionin, pasi cili është roli juaj në të vërtetë sepse në të gjitha dokumentet që janë në Prokurim janë të nënshkuara nga personi i zyrës së Prokurimit? E dyta, sa i përket planit përfundimtar të Prokurimit, dua të ndalem te pika 13 dhe 22. Në këto dy pika janë parapa për karrige, për tepih dhe perde. Ku ju duhen këto, në cilat zyre me na i specifiku këto shpenzime? Me 70.000 mijë euro mundemi me i pa te ndonjë rrugë apo kanalizim që ju hynë në punë qytetarëve.

z.Haqif Arifi: Ka paqartësi dhe gjëra që duhet të cekem. Fillimisht nuk ka lidhshmëri të mjaftueshme me buxhetin vjetorë dhe shihet qartë që është kopje e planit të vitit 2025, sepse ka projekte me të njëjta shifra dhe çmime. Nuk ka lidhshmëri mes drejtorisë së Prokurimit dhe drejtorisë së Financave. Jo të gjitha projektet që janë në buxhet janë futur në planifikimin e Prokurimit, mungesë e transparencës, nuk ka ndarje të procedurave. Nuk ka menaxhim të rrezikut. Nuk dihet si ka ecur plani, nuk është bërë një krahasim i planit të vitit të kaluar, sa kërkesa nga operatorët do të ketë, vonesa në tenderim apo edhe oferta jokonkuruese. P.sh në fshatin Gjyrkoc në planifikimin e Buxhetit 2025, në planin e Prokurimit 2025, në Kornizën Afatmesme 2026-2028 por dhe në miratimin e Buxhetit 2026 është paraparë dislokimi i fushës sportive në fshatin Gjyrkoc me një vend tjetër të caktuar. Nuk di qysh nuk e ka gjetur vendin këtu, nuk është futur në këtë plan. Ne e dimë që ky ka qenë edhe zotim që me u bë dislokimi i fushës. Nuk e di që ka një fushë sportive dhe nuk e di që është e pa rrethuar në Shtime. Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore, sa është shuma e përafërt dhe çka është menduar me projekte ideore kryesore? Kam edhe një pyetje për Drejtorin, sa përqind i planit të Prokurimit të vitit të kaluar është analizuar 100% dhe cilat projekte nuk kanë filluar fare apo nuk janë realizuar në tërësi. Pse nuk është bërë një analizë krahasuese për të parë sukseset dhe dështimet? A është ky planifikim në harmoni me buxhetin e miratuar? A është ky planifikim një dokument real apo vetëm për të përmbushur një obligim ligjor? Sa projekte në planin e Prokurimit të vitit 2026 kanë mbështetje të fortë financiare dhe nëse po, sa projekte janë fut në planifikim pa disponueshmëri buxhetore? A ka pas bashkëpunim mes DPP dhe DBF? Sa dhe si e arsyeton para qytetarëve një planifikim Prokurimi që nuk tregon se sa, as kur do të përfundojnë këto projekte?

znj.Erza Salija: Kërkoj që nga Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit një informatë për vonesën e lidhjeve të kontratave si rezultat i ankesave nga operatorët ekonomik, në seancën e radhës nga Drejtori i Prokurimit informatë më të detajuar. Sa kontrata janë shkëputur në mënyrë të njëanshme si rezultat i dështimit të punimeve? Sa nuk janë lidhur si rezultat i ankesave dhe shkaktu vonesë në përfundimin e punimeve? Cilat janë arsyet më të shpeshta të këtyre ankesave dhe në çfarë fazë po bëhen këto ankesa, në fazën e publikimit apo në fazën e njofimit?

z.Faik Ramadani: Te ky planifikimi përfundimtar edhe neve disa gjëra na u duken të arsyeshme ndërsa disa të pa arsyeshme, por Drejtoria besoj se na sqaron. Po më çudit furnizimi me internetit në shkollë dhe nuk kisha dashtë që interneti të përdoret nëpër shkolla. Me numër 5 mirëmbajtja e varrezave, kërkoj me e ditë a janë të përfshime të gjitha varrezat e Komunës së Shtimes? Te Drejtoria për Shërbime Publike me 3000 mijë euro kujt i jepen këto para? Me numër 25 mirëmbajtja e infrastrukturës a janë të përfshirë të gjitha fshatrat apo si është puna? E kam thënë edhe mbledhjen e parë që këto punime të jenë të përfunduara. Rruga “Kadri Musolli”, rrugë që as një nga qytetarët e Pjetërshicës nuk e njeh, nuk ka një rrugë të tillë. Rruga “Ajet Gashi” është rrugë e shtëpiave po ashtu. Rrugët kryesore i kam të gjitha të fotografuara dhe nëse nuk i dini mundem me ja u treguar. Nese doni mundem me i ndihmu Drejtoris me i specifikuar se cilat punime duhet me u rregulluar, dhe jo me i lënë të pa qarta sepse po kanë probleme.

znj.Fatlinda Rrafshi: Sa është shuma totale që është paguar për planin e hartimit të PZHK-së?

z.Demokrat Mujota: Pyetja ime ishte kjo që sapo e përmendi kolegja. Pika 93/4 jetike për Komunën e Shtimes është që sa më shpejt të votohet një PZHK-së. Sa është afati që ka me u bë PZHK-ja? A mundesh me specifiku çka është paguar me 50 mijë euro, sepse qytetarët janë duke paguar gjoba pa nevojë?

z.Besnik Seferi: Ky është plan i prokurimit dhe jo Plan Zhvillimor, isha ndal te çështja e cilësisë. I kam dy pyetje. Sa ka me i plotësu nevojat reale ky plan në tërësi? Rr. “Qamëria” dhe “Anton Qeta” është planifikuar një rrethrotullim, çfarë ka ndodh me atë rrethrotullim sepse janë ndarë mjetet? Rruga e Carralevës edhe pse është në kuadër të Ministrisë por është pjesë e Shtimes, pse nuk është fol për këtë rrugë fare sepse është shqetësuese?

z.Shefqet Krasniqi: Tani po shihet që ka shumë vërejtje pothuajse në secien kolonë dhe një shumicë e tha prej kolegëve, une e kam një pyetje. Po flitet për Belincë, rruga “Skënderbeu” që është e planifikuar për vitin 2026, Drejtor e di fortë mirë sepse kam jetuar pikërisht në atë lagje 24 vite kjo rrugë që tri vite veçse është përfunduar, më shumë se 2 vite jam i sigurtë. Çështja tjetër është te kërkesat e mija që i kam pas për investime, më shumë po ja lë edhe gabim teknik. Rregullimi i segmentit i rrugëve Lagjia Dugolli në rregull, Lagjia Asllani në rregull, Lagjia e Jasharëve në rregull dhe Godeni në rregull, por nuk kam kërkuar që të bëhet pastrimi apo rregullimi i varrezave në Dugë dhe Karaqicë, po megjithatë është shumë e mirëpritur, por megjithatë po besoj që është një gabim teknik sepse kemi kërkuar edhe një rrugë tek zabeli i vorreve.

znj.Fatlinda Rrafshi: Dua të ndërlihem te rruga e Carralevës, e dimë që është projekt i nivelit qendror, por kur ndahen 350.000 mijë euro për mirëmbajtje të infrastrukturës kishte me qenë mirë me u dakordu me qeverinë dhe me u bë rrregullimi i asaj rruge.

znj. Albana Podvorica-Hoxha: Këtu e kemi “Furnizimi me mobilje” do të ishte më mirë me u specifiku se ku kan me shku këto mobilje, sepse nuk po e dimë për cilat institucione po bëhet fjalë. Më pas e kemi “Furnizim me paisje të ndryshme për institucionet e Komunës së Shtimes”, me ditë në cilat institucione edhe çfarë furnizime jeni duke bërë apo me çfarë paisje?

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Ju sot para jush e keni një pikë të rendit të ditës që është informatë nga Drejtoria e Prokurimit, po këtu u bënë pyetje edhe për DSHP dhe për DZHE edhe për DPUKGJ, po pasi që nuk janë drejtorat këtu e pash të arsyeshme që t’a them atë që edhe ne jemi të vetëdijshëm për planin e Prokurimit dhe për planifikimet që bëhen brenda Komunës. Nuk është në harmoni plani i Prokurimit me buxhetin sepse më vonë është votuar buxheti. Plani qëndron i njëjti. Ka projekte që janë planifikuar që të përfundojnë për 3-4 vite, mirëpo kanë përfunduar për një vitë. Rruga e Carralevës është e buxhetuar. Plani i Prokurimit me ligj duhet me qenë në fillim të vitit dhe buxheti është votuar më vonë. Ne kemi tentuar me pasë një rrethrotullim te lagjia e Pajtimit mirëpo me kërkesë të linjës së autobusëve është dashur me u largu sepse ka qenë rrethrotullim i vogël. Ne kemi bisedu edhe me pronarët e pronave private që ishin aty afër mirëpo nuk kan pranuar që të i shpronësojnë pronat.

z.Valon Januzi, DPP: Atëherë unë po besoj që parimishtë DZHE e bën njësimin e kërkesave dhe në bazë të kësaj i bëjmë kërkesat. Këtu u bënë shumë pyetje, për çështjen e mirëmbajtjes si infrastrukturës po besoj që Drejtoria për Shërbime Publike e ka dhënë arsyetimin e tyre kur e ka bërë kërkesë dhe kjo nuk përshkon asnjë rrethanë me rrugën e Carralevës që është rrugë

nacionale. Ministri z.Dimal Basha e ka dhënë përgjigjen për atë pyetje. Infrastruktura ka nevojë për mirëmbajtje, sepse persona të pa përgjegjshë kanë bërë dëme. Meqënëse ka pas vonesë të buxhetit, një përqindje e planit të Prokurimit ka filluar të zbatohet. Te pyetja e z.Bajramit për rolin në Drejtori, unë po besoj që Ligji për Vetëqeverisje Lokale e parasheh qartë që Drejtori është në cilësinë e Këshilltarit të Kryetarit dhe rrjedhimisht është mbikqyrës i detyrës së tij. Në këtë rast kam stafin tim sikur çdo drejtor që e ka. Te çështja e pyetjeve të z.Haqif ka bërë pyetje shumë dhe përgjigjen do t'a merrni me shkrim. Po besoj që njëra nga pyetjet që ke ishte mos përputhja e buxhetit me planin. Ka mos përputhje për shkakë të ndryshimit të planifikimit. Sa i përket prioriteteve, ato që janë prioritetet më të mëdha vendosen në këtë plan.

z.Demokrat Mujota: I nderuar drejtor z.Januzi, nëse iu drejtohesh znj.Fatlinda që po bën pyetje të gabuara dhe kjo insistoi që nuk ka pyetje të gabuar dhe ju iu kthyet me "ti je naive" është ofendim, kështu që duhet me kërkuar falje. Ne e dimë që roli yt si drejtor nuk është rol zbatues por është rol që i fillon punët, a mund të na tregoni specifikisht kur ju i keni nis këto procedura, kujt ju kanë paguar 50.000 mijë euro për PZHK-në, sepse ju i keni filluar dhe nuk më treguat, më mbetet borxh dhe kur pretendohet që PZHK-ja me dalë në dëgjim publik dhe pastaj me ardhë në Kuvend dhe ne me votu dhe Komuna jonë pas 7-8 viteve me e bë një PZHK aktive?

z.Haqif Arifi: Nëse Drejtoria e Prokurimit Publik ka pas bashkëpunim me drejtori të tjera është dashtë me i marrë me i specifiku dhe me bë një krahasim mes të projekteve të realizuara, të pareaizuara dhe ato të cilat duhet me u fut të buxhetuara. Ka gjëra që nuk i dimë për të kaluarën por këto që i kemi në dorë dimë të lexojmë. Ju i keni renditur kërkesat e drejtorive por nuk i keni verifikuar, për këtë arsye ju pyeta që a e keni bërë një krahasim të projekteve. A ka pas një planifikim hartimi i projekteve, i ideve sa është shifra? Po ashtu i njejt projekt është futur dy herë por shumat ndryshojnë.

z.Shefqet Krasniqi: Nën kryetar, po iu drejtohem juve ngaqë nuk është drejtori për Urbanizëm. E përmendët te rrethi i Godancit, po më duket pak shumë e thjeshtë përgjigjia. Për çdo punë që duhet ti filloj duhet të bëhet një analizë paraprakisht, përgjigjia është shumë e thjeshtë në atë kuptimin. Nuk po dua kesi përgjigjie. Nuk kemi dokument a është anuluar apo është bërë ndonjë kërkesë për dikund tjetër.

z.Bajram Hajrizi: E përmendi edhe në fillim Profa Haqif veçse e tha që ky plan është copy-paste i vitit 2025, edhe vitin e kaluar keni kërkuar perde dhe tepihë për Komunën, ku i keni lënë? Te shkolla në Reçak për mirëmbajtjen e kubëzave, 75.000 mijë euro për 3 kocka në Reçak?

z.Muhamet Ademaj: Apo i parashtrojme pyetjet për DPP apo ndonjë drejtori tjetër, sepse shumica e pyetjeve sa po e shoh kanë të bëjnë me DUPKGJ?

z.Haqif Arifi: Ne jemi të obliguar me i bë pyetjet sepse drejtori që është këtu prezent e ka marrë barrën e gjithë drejtorave dhe i ka futur projektet në planifikim të Prokurimit, është mirë me ditë me i dhënë edhe përgjigjet.

Nën kryetar, z.Adnan Ademi: Këtu është Kuvend dhe këtu ka rend dite dhe ka rregull, nëse ka pyetje të veçanta duhet të bëhen në pikën pyetje-përgjigjie. Nuk ka qenë ide e jona ndërtimi i rrethrotullimit, por kërkesë nga qytetarët në dëgjime publike. Asnjë cent nuk ia kemi dhënë kompanisë për këtë rrethrotullim, ka qenë vetëm improvizim. Brenda lagjës janë shtruar shumë rrugë me atë buxhet të ndarë edhe qytetarët e kanë parë që nuk bën që ai rrethrotullim të jetë aty.

znj.Fatlinda Rrafshi: Cilët banorë i keni pyet në Lagjen e Pajtimit që me i bë ato shpronsime të pronave për me e liru hapësirën që me u bë rrethi?

Nën kryetar, z.Adnan Ademi: Ti nuk e din çka kanë kërkuar qytetarët, si asambleiste e PDK nuk e keni marrë mundin me marr pjesë në dëgjimet publike. Ju nuk e dini çfarë kanë kërkuar banorët. Mund t'i merrni procesverbalet e dëgjimeve publike dhe t'i lexoni dhe aty mund t'a shhini që ka qenë kërkesa e banorëve. E thash edhe më herët, ne nuk marrim vetëm kërkesa të asambleistave për bazë, por edhe të qytetarëve.

z.Haqif Arifi: A ka mundësi që të n'a siguron që të gjithë drejtorat të jenë prezent në pikën pyetje-përgjigjie?

Nën kryetar, z.Adnan Ademi: Drejtorat kanë qenë me një aktivitet tjetër paradite dhe besoj që do të jenë prezent pas pauzës.

z.Besnik Seferi: I qëndroj mbrapa pyetjes që me ditë se ku kanë mbetur ato para të planifikuara.

Nëse thuhet që janë ndarë, unë do të kërkoj përgjigje nga drejtori i kaluar se për ku janë ndarë ato para.

z.Valon Januzi, DPP: Drejtori i DBF na jep përgjigje për PZHK-në. Për pjesën e kërkim faljes, nuk kam bërë diçka që duhet të kërkoj falje. Unë e di që ka qenë i planifikuar me buxhet, dhe e di që ka qenë një peticion kundër dislokimit të fushës, ku ministria iu ka përgjigj dhe e ka anuluar. Në plan të DPP ka projekte që janë planifikuar për 2-3 vite.

z.Haqif Arifi: Për dislokimin e fushës ka pas peticion me disloku fushën, ndërsa peticion për mos me lëviz fushën nuk e di nëse ka pas.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Plani i Prokurimit nuk përputhet me buxhetin, dihet se kategoria e subvencioneve nuk shkon në plan të DPP. Ka edhe shpenzime të tjera që nuk hynë në plan të DPP. Të gjitha projektet janë në pajtueshmëri me planin. U diskutua për furnizimin me veshmbathje, është për pacientët më të ndishëm, e njohin këtë fushë z.Arifi dhe znj.Syla sepse kanë punuar në këtë fushë, prandaj kjo pjesë nuk duhet as që të diskutohet. Pjesa tjetër është për mirëmbajtje të çerdheve dhe institucioneve tjera. Te projektet ideore është një kontratë që është paraparë me u lidhë. Pagesa e PZHK-së është bërë vitin e kaluar.

z.Shefqet Krasniqi: Megjithatë çështja e veshmbathjeve nuk është diskutuar as nga LDK as nga prof.Haqif. Çështja është specifikimi, ku kemi kërkuar çdo mbledhje specifikim të gjërave se ku kanë me shku. Nëse do t'a dinim që kjo shumë 6000-7000 mijë euro do të shkonte për atë kategori secili do të jepte para ndoshta edhe nga gjepi i vet diçka.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime tjera po kalojmë tek pikat e tjera shitesë të rendit të ditës.

Pika 7

Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit Npi-01/17 datë 31.01.2011, (Pikë shtesë)

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Ja jep fjalën z.Besnik Seferit.

z.Besnik Seferi: Propozimi i parë ishte nga Demokracia për futjen e rendit të ditës Shqyrtimi i kërkesave, ndërsa si propozim i dytë ishte çështja që të largohet Raporti Financiar, për faktin që kinse nuk është marrë me kohë materiali e që pak keni edhe ju faj si Kryesues, shkak i neglizhencës tuaj që nuk e keni respektu hiearkinë bashkërisht me drejtorin që me kërku këtë raport. Sa i përket pikës une jam i vetëdijshëm. Nuk mundem me hy dy propozime në një propozim. Mirëpo ju po e shkelni rregulloren.

z.Demokrat Mujota: Rendi i ditës ashtu siç ka ardhur nuk u votua. Ishin dy kërkesa, besoj që duhet të jemi konstruktiv dhe të vazhdohet me këtë rend të ditës.

z.Shefqet Krasniqi: Edhe njëherë, ne e potencuam dhe kërkuam që pika sa i përket Pasqyrave Financiare të shtyhet për seancën tjetër pasi që materiali na ka ardhë vonë dhe besoj që u morrëm vesh për atë pikë.

z.Faik Ramadani: Po kërkoj që te pika pyetje-përgjigje të kemi kohë më shumë.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime tjera po e hedhë në votim shfuqizimin e Vendimit Npi 01/17 të vitit 2011.

- Në vazhdim në orën 13.07h, mbledhjen e Kuvendit e lëshuan, në shenjë paknaqësie dhe mospajtimi me futjen e këtyre pikave shitesë në rendin e ditës anëtarët e Kuvendit nga Grupi parlamentar i LVV-së si vijon: z.Besnik Seferi, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, z.Artan Lubovci, znj.Adelina Shabani, z.Zenel Shabani, si dhe anëtar i pavarur i Kuvendit z.Muhamet Ademaj.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi, Vendimin për Shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/17 të datës 31.01.2011, për Adresimin e Kërkesave të Qytetarëve.**

Pika 8

Propozim-Vendim për ndryshimin e nenit 6.9 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 datë 27.04.2023, (Pikë shtesë)

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Duhet të bëhet ndryshimi i nenit 6.9 i Rregullorës së punës së Kuvendit. Nëse keni ndonjë rekomandim për tekstin, urdhëroni.

z.Shefqet Krasniqi: Unë kisha dashtë nga Profa një sqarim me atë që e ka thënë specifikisht që ta kemi të qartë të gjithë.

z.Haqif Arifi: Unë kisha propozuar që mos të quhet zyrë pritëse, sportel por arkivë.

z.Demokrat Mujota: Më vjen keq për anëtarë e LVV-së që sa herë flitet për zërin e qytetarëve, kur vjen puna te qytetarët LVV-ja nuk është këtu për ta.

z.Muhamet Ademaj: Pasi këtu jeni shumica, po shihet që po vendosni si LDK-PDK. Sa i përket votimin që e bëtë këtu sipas meje keni bërë shkelje, sepse nuk keni të drejtë me i futë dy pika të rendit të ditës shtesë, por besoj që MAPL ka me hedhë poshtë këtë vendim. Nëse ne punojmë sipas rregullores nuk kemi me pas problem.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Po e kuptoj shqetësimin tuaj, por po t'a bëj me dije që në pushtetin e kaluar jo vetëm që jan futë 2-3 propozime, por është ndryshuar komplet rendi i ditës. MAPL-ja mundet me sjellë opinion ligjor që kemi bërë shkelje. Nëse i kishim fut me një pikë të gjitha këto propozime atëherë do të kishim bërë shkelje. Kërkesat e qytetarëve ne nuk mundemi me i ndal, qytetari dëshiron me vendos kujt me iu drejtu me kërkesa. Nëse kishim dëshiruar me tregu arrogancën e votës siç po thoni, atëherë ne do ti dërgonim 3 anëtarë të PDK-së tek KPF.

z.Muhamet Ademaj: E di që ti ke qenë Kryesues. Nuk e di që drejtëpërdrejtë kërkesat e qytetarëve kanë ardh në Kuvend, prandaj kontrolloe arkivin Kryesues. Palët i drejtojnë kërkesat në arkiv, ndërsa ato kërkesa shikohen se a janë për Kuvend. Mund të themelohet një Komision, nuk është fare problem.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime tjera po e hedh në votim.

z.Haqif Arifi: Kisha dashtë të shtoj edhe këtë pjesë në tekst "ndërsa kërkesat për Drejtoritë përkatëse të adresohen te ato ku e kanë adresën".

z.Shefqet Krasniqi: Po citoj, "kërkesat të cilat vinë nga qytetarët dhe dorëzohen në arkivë. Pas shpalosjes së asaj kërkesë, nëse arkiva e sheh që ajo kërkesë i është drejtuar Kuvendit apo cilit do organ, t'a drejtojë te organi përkatës", apo jo?

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Konstatoj që në mbledhje janë 11 anëtarë prezent.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi, Vendimin për ndryshimin e Nenit 6.9 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Nga formulimi ekzistues në Rregullore si vijon: "Kërkesat e palëve që paraqiten te zyra pritëse, duhet fillimisht të adresohen te Ekzekutivi i Komunës përkatësisht te Drejtoria Kompetente, dhe pastaj nëse Drejtoria e konstaton se kërkesa duhet të adresohet në Kuvend ajo e transferon Kërkesën e palës në zyrën e Kuvendit së bashku me rekomandimin e sajë."**

Në formulimin e ri si vijon: "Kërkesat e palëve dorëzohen në Arkivin e Komunës, i cili bënë pranimin, evidentimin dhe shpërndarjen e tyre sipas adresimit të bërë nga pala. Zyrtari përgjegjës i Arkivit, pas pranimit dhe regjistrimit të kërkesës, e përcjell atë drejtëpërdrejt te organi kompetent, përfshirë Kuvendin e Komunës apo drejtoritë përkatëse, në përputhje me përmbajtjen dhe adresimin e kërkesës, pa qenë e nevojshme që kërkesa të kalojë paraprakisht nëpërmjet Ekzekutivit të Komunës."

Pika 9

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ia dha z.Shefqet Krasniqit.

z.Shefqet Krasniqi: Te pika e fundit, nuk më erdhi mirë ai gjest që LVV-ja e lëshoj sallën. Ne kemi shumë pyetje por nuk kemi se kujt të ju drejtohem sepse Ekzekutivi nuk është këtu. Ndoshta edhe mund të kthehen por ata nuk e konfirmuan nëse do të kthehen. Si grup parlamentar i LDK-së nuk kemi kujt t'i drejtohem me pyetje.

z.Demokrat Mujota: Ne si grup kemi pas shumë pyetje për Ekzekutivin, por Ekzekutivi e liroj sallën dhe nuk ka kush me u përgjigj, por besoj që me një mbledhje të tjetër si pikë të parë e vendosim pikën Pyetje-Përgjigje.

z.Bajram Hajrizi: Pajtohem me ato që u thanë, por po ndërlihdna me atë që e tha Nënkrjetari z.Ademi se do të kthehen në sallë, kishte me qenë më mirë me bërë pak pauzë edhe Ekzekutivi me ardh për hirë të qytetarëve.

z.Faik Ramdani: Pajtohem edhe unë me atë që u tha, por kisha kërkuar që me i lënë anash interesat tona politike dhe të punojmë për interesat e qytetarëve. I kisha kërkuar nga kjo ulëse që për mua është e shenjtë, po iu drejtohem Kryetarit z.Aliu që pavarësisht obligimeve të marrë pjesë në mbledhje që të punojmë të gjithë së bashku.

- Në ora 13.25h në mbledhjen e Kuvendit janë kthyer anëtarët e Kuvendit nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje si vijon: z.Besnik Seferi, z.Faruk Beqa, z.Artan Lubovci, znj.Adelina Shabani, z.Zenel Shabani.

z.Besnik Seferi: Nuk e besoj që është e nevojshme për këtë pauzë për faktin që dy drejtorë veçse i kemi prezent. Sikurse ju, edhe ne i kemi pytet tona.

z.Demokrat Mujota: Besnik, ju ishit në pauzë dhe ne kemi nevojë për pauze mbas 30 minutave.

z.Shefqet Krasniqi: Koleg, po e kërkojmë një pauzë akademike, do të ishte mirë.

z.Besnik Seferi: Demokrat, ne nuk ishim në pauzë por thjeshtë kemi qëndruar jashtë sepse i kemi bojkotuar ato pika.

Kryesuesi, z.Rahman Jakupi: Në rregull pra, pasi që të gjithë jeni të pajtimit po shkojmë në një pauzë 15 minutëshe, në ora 13:30h.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Me rregullore nuk lejohet kalimi i gjithë këtyre propozimeve me një propozim, ke bërë shkelje të Ligjit dhe të Rregullores.

Kryesuesi, z.Rahman Jakupi: Vazhdojmë pas pauzës në ora 14:14h.

z.Shefqet Krasniqi: Konsiderojmë që të mbetet për seancën tjetër pika Pyetje-Përgjigje pasi që Ekzekutivi nuk është këtu.

z.Demokrat Mujota: Pajtohem edhe unë, Ekzekutivi nuk i është përgjigj kërkesës tonë, prandaj duhet të shtyhet kjo pikë.

z.Faik Ramdani: Po ndjejë keqardhje për anëtarët e Ekzekutivit dhe Legjislativit nga ana e LVV-së, të cilët tash braktisën sallën e Kuvendit. Po ndihem keq për qytetarët që as në mbledhjen e kaluar e as në këtë mbledhje nuk i kemi bërë pyetjet. Shpresoj që LVV-ja duhet të reflektojë me përgjegjësi ndaj qytetarëve të Komunës së Shtimes, sepse tek e fundit edhe ne kemi përgjegjësi para tyre por në këtë rast jemi të pafuqishëm me vendos diçka.

Kryesuesi, z.Rahman Jakupi: Pasi që diskutime tjera nuk ka, atëherë po e përfundojmë këtë mbledhje në ora 14:17h.

Procesmbajtëse
Sadberë Halili



Kryesuesi i Kuvendit
Rahman Jakupi

